

**AKT- THEMELIMI  
I SHOQËRISË TREGËTARE ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR**

**“KEDD INVESTMENT” SH.P.K.**

Unë, Demokrat BENGASI, i biri i Kastriot dhe i Elidës, lindur më 30.06.1991 në Kamëz, Tiranë, Shqipëri, dhe me banim në adresën rruga “Hali Xhuzi”, Nd.21; H; 1, Njësia Administrative Nr.11;1029, Kamëz,Tiranë, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, madhore dhe me zotësi të plotë datë 23.10.2019;

Në bazë të legjislacionit shqiptar kam vendosur me vullnetin tim të lirë dhe të plotë, të themelojë shoqërinë tregtare private, me përgjegjësi të kufizuar, e cila do të rregullohet në mbështetje të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”; i ndryshuar; ligjt Nr.9723 date 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, si dhe të legjislacionit shqiptar në fuqi dhe normave që vijojnë:

Neni 1

**Emri, Forma**

- 1.1 Shoqëria do të ketë emrin tregtar **“KEDD INVESTMENT” shpk** dhe formë ligjore: Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar “SHPK” (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).
- 1.2 Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin Shqiptar dhe me aktet e themelimit të saj.

Neni 2

**Selia**

- 2.1 Shoqëria e ka selinë në adresën: Rruga "Liman Kaba", Olimpik Rezidens, përballë Parkut Olimpik Shkalla 3, Hyrja nr 304, katë 3, Tiranë.
- 2.2 Kontakti : Demokrat Bengasi :Tel+355 68 90 18686 ;e mail : [demokratbengasi@gmail.com](mailto:demokratbengasi@gmail.com)

Neni 3

**Objekti i veprimtarisë**

- 3.1 Objekti i veprimtarisë të shoqërisë do të jetë:

- *Investime në fusha të ndryshme, brenda dhe jashtë teritorit të Shqipërisë; Import dhe Eksport të artikujve ushqimor, industrial, artikujve në fushën e ndërtimit të veprave private, publike dhe në çdo sektor tjeter që ka interes për shoqërinë; Tregëtimin e*

*artikujve të ndryshëm të të gjitha llojeve, si: Tregëtim artikujve industrial; Tregëtim artikujve ushqimore; Tregëtim mallrash të të gjitha llojeve brenda dhe jashtë vendit; Tregëtim dhënie, marrje me qira automjetesh të çdo lloji, marke e tonazhi, si dhe pjesë këmbimi për to; Tregëtim, montim, riparim paisjesh elektro-shtëpiake, elektronike, elektrike, kompjuterike, higjeno-sanitare dhe hidraulike, prodhime qeramike, artizanati, paisje zyrash etj; Hapje dhe shfrytëzim hotelesh, motelesh, diskotekash, bar-kafe, lojra argëtuese për fëmijë, qendër sportive, qendra pushimi e kurative; Blerje dhe shitje të pasurive të lujtëshme dhe të palujtëshme etj;*

- Çdo veprimtari tjetër të lejuar nga ligji dhe/ose pjesëmarrjen në çdo veprimtari apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryejë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar në bazë të legjislacionit Shqiptar.

Për realizimin e objektit të veprimtarisë shoqëria mund:

- Të lidhë kontrata me klientët qoftë person fizik ose juridik, Shqiptarë apo të huaj.
- Të themelojë partneritete për kryerjen e investimeve dhe shërbimeve si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- Të marrë pjesë me aksione/kuota edhe në shoqëri të tjera vendase, të huaja ose me kapital të përbashkët që kanë objekt shoqëror dhe aktivitet të ngjashëm me të.
- Të krijojë filiale dhe zyra përfaqësie në qytete të tjera të Shqipërisë ose në shtete të tjera, në përputhje me legjislacionin e tyre.

- 3.2. Në përputhje me legjislacionin shqiptar, në mënyrë që të arrihet qëllimi i sipërpërmendur, Shoqëria mund :
  - (i) të kryejë çdo aktivitet tregtar, finanziar, dhënie-marrje me qira, të vendosë pengje dhe barrë hipotékore; aktivitete këto të konsideruara si të dobishme apo të nevojshme për të arritur qëllimet e Shoqërisë dhe që nuk tejkalojnë në masë aktivitetet kryesore, të cituara më sipër;
  - (ii) të kryejë aktivitete publikimi dhe reklamimi.
- 3.3. Shoqëria kryen çdo lloj aktiviteti që bën pjesë në objektin e saj, që lidhet me të dhe që e mbështëet atë.
- 3.4. Shoqëria zbaton të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore të duhura. Ajo zbaton standartet më të larta të etikës.
- 3.5. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj në çdo kohë siç parashikohet në Statut.

Neni 4  
**Kohëzgjatja**

- 4.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj pa afat.



Neni 5  
**Kapitali themeltar.Kontributet**

- 5.1 Kapitali themeltar i nënshkruar i shoqërisë është **100,000,000** (*Njëqindmilion lekë*) i ndarë në 1 kuotë, e cila zotërohet nga ortaku i shoqërisë, si më poshtë:

*Demokrat Kastriot BENGASI zotëron 1 kuotë me vlerë 100,000,000 (Njëqindmilion) lekë, e cila përbën 100% të kapitalit filletar të shoqërisë..*

Neni 6  
**Ortakët e Shoqërisë dhe Kuotat**

- 6.1 Ortaku i shoqërisë është Zoti Demokrat Kastriot Bengasi.
- 6.2 Kapitali themeltar i nënshkruar i shoqërisë zotërohet nga ortaku i shoqërisë, si më poshtë:
- Demokrat Kastriot BENGASI zotëron 1 kuotë me vlerë 100,000,000 (Njëqindmilion) lekë, e cila përbën 100% % të kapitalit filletar të shoqërisë.*
- 6.3 Kontributi i ortakut është në para dhe në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).
- 6.4 Ortaku nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributet e ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

Neni 7  
**Administratori**

- 16.1 Shoqëria drejtohet nga Administratori. Administratori i Shoqërise do të jetë **Zoti Demokrat BENGASI**, i biri i Kastriot dhe i Elidës, lindur më 30.06.1991 në Kamëz, Tiranë, Shqipëri, dhe me banim në adresën rruga “Hali Xhuzi”, Nd.21;H; 1, Njësia Administrative Nr.11;1029, Kamëz,Tiranë, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi (ID Card) Nr. Pers. J10630064W, lëshuar më datë 23.10.2019;
- 16.2 Kohëzgjatja e funksionit të Administratorit është 5 (pesë) vjet, me të drejtë ripërtëritje.

Neni 8  
**Dispozita të fundit**


- 27.1 Ky Akt Themelimi rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet shqiptare.
- 27.2 Ky Akt Themelimi u hartua nën konsulencën e shoqërisë “**MZ PARTNERS**” shpk, me Nipt M31510010U.



- 27.2 Autorizohet administratori i shoqërisë “***MZ PARTNERS***” shpk zoti Thoma Marko i biri i Vasilit dhe i Liljanës, lindur më 12.10.1982 në Pogradec, me kombësi dhe shtetësi Shqiptare, madhor me zotësi juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal I21012150K, me adresë banimi:Ruga "Xhon Kenedi, pall Solued, kati 4, Ap.22, Tiranë", që edhe në mungesën time, të kryej të gjitha procedurat për rregjistrimin e shoqërisë dhe dhe të bëj deklarimet dhe depozitimet e nevojshme pranë çdo organi të shtetit shqiptarë dhe personave juridike e fizikë, vendas dhe të huaj.
- 27.3 Ky Akt themelim hartohet në dy kopje orgjinale

Tiranë, Datë 25/05/2023

ORTAKU

  
Demokrat Bengasi